LIGJ
Nr.9787, datë 19.7.2007

PËR NJË SHTESË NË LIGJIN NR.7638, DATË 19.11.1992 "PËR SHOQËRITË TREGTARE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Në fund të nenit 47 të ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare", të ndryshuar, shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Përjashtimisht këtij rregulli, në shoqëritë me kapital të përbashkët, për kapitalin shtetëror, që i përgjigjet pasurive të paluajtshme të shoqërisë, që i janë njohur ose kthyer ish-pronarëve, sipas legjislacionit në fuqi, ortaku shtetëror zëvendësohet nga ish-pronari në të drejtat e tij mbi pjesën takuese të këtij kapitali. Transferimi i pjesëve të kapitalit në favor të ish-pronarit, i cili zëvendëson shtetin në të drejtat e tij mbi këtë pjesë kapitali, bëhet me akt noterial, sipas procedurave të parashikuara në ligj.".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5442, datë 31.7.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi